

Grenelli: Thaçi për 4 vjet
në burg, kjo nuk është
vlerë perëndimore



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET AMBASADORI AMERIKAN JEFFREY HOVENIER

SHBA-ja BESON FUQISHËM SE NUK ËSHTË KOHA PËR HAPJEN E URËS SË IBRIT

F. 3

- Nuk kam parë shumë entuziazëm të ShBA-së për mbështetje të përpjekjeve të qeverisë për anëtarësime të reja në organizatat ndërkombëtare



Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se shteti që përfaqëson beson fuqishëm se nuk është koha për ta rihapur urën për qarkullim të automjeteve. Ai ka thënë

se hapja e Urës në këtë kohë mund t'i rrezikojë ushtarët amerikanë. Hovenieri ka thënë se ShBA-ja është sfiduar nga kryeministri Albin Kurti dhe qeveria e tij në disa aspekte. Ai ka

thënë se veprimet e pakoordinuara të qeverisë në veri e zvogëlojnë entuziazmin e ShBA-së për ta mbështetur Kosovën në rrugën e saj euroatlantike

MUSMURATI
E PDK-SË:
EDHE SIVJET
QEVERIA KURTI
PO I LË NXËNËSIT PA
LIBRA NË FILLIM TË
VITIT SHKOLLOR

F. 3



MIFTARAJ: KOSOVA S'KA STRATEGJI
PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT,
KAQ ËSHTË VULLNETI I QEVERISË

F. 3



NDAHEN 4 MILIONË EURO PËR
NDËRMARRJEN "TREPÇA"

F. 8

PECI: FERMERËT QË SHKAKTOJNË
ZJARRVËNIE TË QËLLIMSHME DO
TË PËRJASHTOHEN PËR 3 VJET
NGA SUBVENCIONET DHE GRANTET

F. 8

FBK-JA SHPALL KONKURS PËR
ORGANIZIMIN E SUPERKUPËS

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ambasadori gjerman mbështet linjat e kuqe të KFOR-it për urën e Ibrit dhe kërkon shtensionim

PRISHTINË, 14 GUSHT - Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, ka thënë të mërkurën se mbështet plotësisht linjat e kuqe të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, për urën kryesore mbi lumin Ibër. Kjo urë - që ndan Mitrovicën Jugore me shumicë shqiptare me Mitrovicën Veriore me shumicë serbe - është e hapur për këmbësorët, por jo për vetura. Misioni i KFOR-it ka paralajmëruar se nuk do të hezitojë të veprojë për t'iu përgjigjur zhvillimeve të lidhura me sigurinë, dhe që secili vendim për urën duhet të merret përmes dialogut Kosovë - Serbi të ndërmjetësuar nga dialogu në Bruksel. Çështja e urës është aktualizuar në javët e fundit pasi autoritetet e Kosovës kanë nisur të kryejnë inspektime në urë dhe kanë paralajmëruar hapjen e saj



pavarësisht se faktori ndërkombëtar beson se tani nuk është koha e duhur.

“Veprimet e njëanshme të vitit të kaluar kanë rezultuar me plagosje të ushtarëve të KFOR-it dhe

civilëve, dhe kjo nuk duhet të përsëritet. Duhet të merret parasysh kështilla e

ndërkombëtarëve”, ka shkruar Rohde në platformën “X”. Në maj dhe qershor të vitit të kaluar dhjetëra ushtarë të KFOR-it janë plagosur në protestat e disa serbëve lokalë në veri të Kosovës të cilët e kanë kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në tri komuna veriore me shumicë serbe – Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. “Është e nevojshme një retorikë shtensionimi. Mirëpres koordinimin e përmendur prej kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti”, ka thënë ambasadori gjerman. Kosova dhe Serbia janë pajtuar për hapjen e urës, fillimisht më 2015, më vonë më 2016, në kuadër të dialogut që ndërmjetëson Bashkimi Evropian. Hapja e saj është zvarritur disa herë, dhe faktori ndërkombëtar kërkon që kjo çështje të jetë sërish temë dialogu.

Qeveria e Kosovës vendos të strehojë më shumë gazetarë ukrainas

PRISHTINË, 15 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka vendosur ta rrisë numrin e gazetarëve ukrainas dhe familjeve të tyre të ngushta të cilëve u ofron strehim të përkohshëm në vend si pasojë e luftës në Ukrainë. Qeveria e kryeministrit Albin Kurti e ka miratuar të mërkurën ndryshimin e një vendimi të vitit 2022 për ta rritur numrin e gazetarëve ukrainas, të cilëve u ofron strehim të përkohshëm. “Do të rritet numri i gazetarëve ukrainas, përfshirë anëtarëve të

ngushtë të familjeve të tyre, të cilëve Republika e Kosovës do t’u sigurojë mbrojtje të përkohshme”, ka thënë Kurti gjatë mbledhjes së qeverisë. Ndërsa Blerim Gashani, zëvendësministër i Punëve të Brendshme, ka folur më hollësisht për strehimin e gazetarëve ukrainas, por nuk ka treguar se për sa do të rritet numri i tyre. “Kosova vazhdon të tregojë solidaritet ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut duke u ofruar mbrojtje të

përkohshme gazetarëve ukrainas dhe familjeve të tyre të rrezikuara nga lufta në Ukrainë. Mbrojtja e përkohshme do të ofrohet në përputhje me ligjin për azil dhe do të ketë ndikim të menjëhershëm nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi”, ka thënë Gashani. Sipas Gashanit, gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë ata do të jenë të detyruar ta respektojnë legjislacionin e Kosovës dhe do t’i gëzojnë të gjitha të drejtat që ky legjislacion ua garanton.



Shuhen zjarret në Prevallë



PRIZREN, 14 GUSHT - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije të mërkurën se janë shuar zjarret në Prevallë, në jug të Kosovës, me ndërhyrjen e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR. Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës pati thënë një ditë më parë që zjarret nuk kanë përbërë rrezik për jetën e banorëve. Sipas një postimi në “Facebook” të

komunës së Prizrenit, zjarri është shuar me ujin që është hedhur prej lart dhe nuk ka shenja që situata do të mund të përsëritet. Kosova është përballur në ditët e fundit me temperatura të larta – mbi 35 gradë – ashtu sikurse edhe rajone të tjera të Ballkanit Perëndimor. Prevala është një vendpushim skijimi dhe fshat turistik, i cili

është afërsisht 30 kilometra larg Prizrenit, dhe rreth dymbëdhjetë kilometra nga Brezovica, qendra më e madhe e skijimit në Kosovë. Javën e kaluar është raportuar për zjarre edhe në Parkun Kombëtar të Sharrit, por edhe ato janë shuar. Për zjarre është raportuar në korrik dhe gusht edhe në vendet fqinje të Kosovës, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut.

QKUK-ja: Mbi 46 mijë qytetarë morën ndihmë mjekësore emergjente në gjashtë muajt e fundit

PRISHTINË, 14 GUSHT - Qendra Klinike dhe Universitare e Kosovës (QKUK) ka njoftuar se 46 mijë e 769 pacientë kanë pranuar tretman mjekësor në Klinikën Emergjente për gjashtë muajt e fundit. QKUK-ja ka bërë me dije se

prej këtyre, 4 770 janë pranuar për trajtim të mëtejshëm në klinika të ndryshme internistike dhe kirurgjike. “Nga numri i përgjithshëm i pacientëve, mbi 10 mijë pacientë janë trajtuar në reanimim, 15 mijë në shërbimin internistik, 7

505 raste kirurgjike, mbi 10 mijë pacientë në shërbimin ortopedik. Po ashtu, për këtë periudhë kohore janë kryer 636 operacione në sallat operative dhe mbi 3 mijë raste në sallën e vogël të intervenimeve”, ka njoftuar QKUK-ja.



Grenelli: Thaçi për 4 vjet në burg, kjo nuk është vlerë perëndimore

PRISHTINË, 14 GUSHT - Ish-emisari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Richard Grenell, ka kritikuar evropianët se po përzihen në zgjedhjet në ShBA. Ai ka pyetur nëse është vlerë perëndimore që Hashim Thaçi po mbahet në burg tash e 4 vjet. “Në vend që të ndërhyjnë në zgjedhjet në ShBA

dhe të përpiqeni të krijoni një internet të ri dhe të censuruar për evropianët, pse nuk përqendroheni në rregullimin e gjykatave ndërkombëtare të vendosura në Evropë? A duhet të jetë Hashim Thaçi ende në burg 4 vjet më vonë pa gjyq? Kjo nuk është një vlerë perëndimore”, ka shkruar Grenelli në platformën “X”.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi ndodhen në Qendrën e Paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar më 3 prill të vitit 2023. Ata janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat që ngarkohen nga Gjykata Speciale.



Musmurati e PDK-së: Edhe sivjet qeveria Kurti po i lë nxënësit pa libra në fillim të vitit shkollor

PRISHTINË, 14 GUSHT - Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Besianë Musmurati, ka kritikuar qeverinë Kurti për shkak se po i lë sërish nxënësit pa libra në fillim të vitit shkollor. Musmurati në një konferencë për medie ka thënë se njoftimi i djeshëm nga ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, se librat do të blihen njëloj si vitin e kaluar, është shenjë se 1 shtatori përsëri do të fillojë me kaos, konfuzion e pa libra shkollorë. “Ky është shtatori i tretë me radhë që na gjen me kriza në arsim. Grevat e mësimdhënësve më 2022, mungesa e librave më 2023 dhe, siç po duket, prapë mungesa e librave më 2024. Fatkeqësisht, çdo shtator po e gjen Qeverinë e Kosovës dhe ministrin Nagavci të papërgatitur. Përdorimi i rezultateve të testit PISA na kanë alarmuar, ministrja Nagavci ka vendosur ta vazhdojë eksperimentimin e saj të pakuptimtë, për mossigurimin e librave shkollorë në kohë. Në vend se të bëjmë hapa para me reformë strukturore, ministrja Nagavci po na kthen mbrapa me vendime të gabuara. Pra, edhe njëherë nxënësit e klasave 1 deri në klasën 9 do ta fillojnë vitin pa libra”, ka thënë ajo.

Musmurati ka thënë se qeveria Kurti po i shpenzon mbi 20 milionë euro për blerje të librave të njëjtë që në vitin 2017 janë blerë me rreth 3.5 milionë euro, për mbi 100 mijë nxënës më shumë se tani, e ministres Nagavci nuk po i bëhet vonë, sepse eksperimentet që rezultuan të gabuara, po i përsërit qëllimshëm prapë. “Ministrja na tregoi që janë 218 mijë nxënës që do të subvencionohen me nga 80 apo 110 euro. Nëse e marrim një mesatare që çdo nxënës do të subvencionohet me nga 95 euro, atëherë i bie që buxhetit të shtetit do t'i kushtojë 20 milionë e 776 mijë euro pajisja me libra. Pra edhe vonë, edhe gati trefish më shtrenjtë se nga vitet e kaluara. Për shembull, librin e abetares me shumicë Ministria më herët e ka blerë rreth 7 euro, kurse vitin e kaluar prindërit në librari e kanë blerë rreth 11 euro. Kjo do të thotë për çdo abetare të blerë prindërit kanë paguar rreth 4 euro më shumë. Dhe dje prapë na u tha, që kjo praktikë e dëmshme do të vazhdojë edhe sivjet”, ka thënë nënkryetarja e PDK-së. Sipas Musmuratit, vitin e kaluar



qeveria Kurti e privoi arsimin nga projekti i digjitalizimit, duke i shfrytëzuar fondet e dedikuara për këtë proces për ta mbuluar subvencionimin e librave. “Vitin e kaluar, për ta mbuluar koston shtesë të rreth 8 milionë eurove për subvencionim, qeveria i mori fondet nga projekti për digjitalizim të arsimit. Pra, për të blerë libra më shtrenjtë,

Ministria e Arsimit e sakrifikoi digjitalizimin. Çfarë projekti do të ndalin sivjet për të blerë libra që u kushtojnë më shtrenjtë?”, ka thënë Musmurati. Më tutje, Musmurati ka theksuar se ka pasur nxënës që për dy gjysmëvjetorë shkollorë u kanë munguar disa nga librat. “Për më tepër, në një moment edhe u tha se rimbursimet e fundit të prindërve për vitin e

kaluar janë bërë në maj të këtij viti. Pra, mund të konkludojmë që ka pasur nxënës që, që nga shtatori deri në maj, pra një muaj para se të përfundojë mësimi, nuk ka pasur fare libra”, ka thënë ajo. Musmurati ka thënë se vitin e ardhshëm, në qeverisjen e PDK-së, furnizimi me libra nuk do të jetë më temë e 1 shtatorit, sepse digjitalizimi i proceseve në arsim do të vendoset në shërbim të nxënësve. “Në mënyrë që të sigurohemi që ky keqmenaxhim i parasë publike nuk përsëritet më dhe mungesa e orëve mësimore ndalet, komisioni hetimor parlamentar duhet ta kryejë punën e vet pa ndërhyrje politike të partisë në pushtet sa më shpejt dhe organet e drejtësisë t'i përfundojnë hetimet njëherë e mirë. Lajmi i vetëm i mirë në krejt këtë mes, e që na jep shpresë për të ardhmen, është që veçse jemi në prag të zgjedhjeve të reja. Arbërie Nagavci nuk duhet të jetë më ministre e Arsimit nga viti tjetër. Qytetarët tanë do të mund ta përjetojnë dallimin e mendësisë në qeverisje me ardhjen e Bedri Hamzës dhe ekipit të tij në krye të shtetit”, ka përfunduar Musmurati.

LDK-ja: Ministria e Arsimit u tregua e paaftë për sigurimin e librave për nxënësit



PRISHTINË, 14 GUSHT - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka shprehur shqetësimin lidhur me vendimin e Ministrisë së Arsimit për subvencionimin e teksteve shkollore edhe këtë vit. Udhëheqësja e Departamentit të Arsimit në LDK, njëkohësisht kryetare e Forumit të Gruas, Jehona Lushaku-Sadriu, ka deklaruar se Ministria e Arsimit është treguar edhe këtë vit e

paaftë për përmbushjen e obligimit ligjor për sigurim të librave. “Shprehim shqetësimin tonë që për herë të dytë Ministria e Arsimit dështon t'i sigurojë tekstet shkollore për nxënësit e Kosovës. Kjo tregon që kjo ministri është e paaftë ta përmbushë obligimin ligjor për t'i siguruar librat. Tekefundit është tepër e rëndësishme jo sa

para marrin prindërit, por a i kanë fëmijët librat në bankat shkollore më 1 shtator, rrjedhimisht më 2 shtator, dhe kjo del që është e sigurt që nxënësit nuk do t'i kenë librat dhe do të ketë vonesa në furnizim”, ka thënë Lushaku-Sadriu. Po ashtu, Lushaku-Sadriu ka thënë se “fatkeqësisht, në vend se të flasim për reformën e

cilësinë në arsim, ne vazhdojmë të merremi me furnizim të teksteve shkollore, mjete elementare për fëmijët tanë”. “LDK-ja në programin politik ‘Rrugë e Re’ parasheh koeficient 150 për mësimdhënësit. Përfundimisht LDK-ja konsideron se investimi në arsim nuk është vetëm një detyrë, por një përgjegjësi ndaj gjeneratave të ardhshme”, ka thënë ajo.

Miftaraj: Kosova s'ka strategji për luftimin e korrupsionit, kaq është vullneti i qeverisë

PRISHTINË, 14 GUSHT - Drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka kritikuar qeverinë Kurti për mungesë të luftimit të korrupsionit. Miftaraj ka thënë se Kosova

nuk ka strategji për luftimin e korrupsionit që nga viti 2019 dhe kësaj, sipas tij, qeveria aktuale nuk ka shprehur vullnet për krijimin e një strategjie të tillë. “Kosova s'ka strategji për luftimin e

korrupsionit nga viti 2019. Strategjia për luftimin e korrupsionit miratohet në qeveri. Kaq është vullneti i qeverisë në luftën kundër korrupsionit”, ka shkruar Miftaraj në “Facebook”.





FLET AMBASADORI AMERIKAN JEFFREY HOVENIER

ShBA-ja beson fuqishëm se nuk është koha për hapjen e urës së Ibrit

- Nuk kam parë shumë entuziazëm të ShBA-së për mbështetje të përpjekjeve të qeverisë për anëtarësime të reja në organizatat ndërkombëtare

Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se shteti që përfaqëson beson fuqishëm se nuk është koha për ta rihapur urën për qarkullim të automjeteve. Ai ka thënë se hapja e Urës në këtë kohë mund t'i rrezikojë ushtarët amerikanë. Hovenieri ka thënë se ShBA-ja është sfiduar nga kryeministri Albin Kurti dhe qeveria e tij në disa aspekte. Ai ka thënë se veprimet e pakoordinuara të qeverisë në veri e zvogëlojnë entuziazmin e ShBA-së për ta mbështetur Kosovën në rrugën e saj euroatlantike

PRISHTINË, 14 GUSHT - Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë ekziston një rrezik real i lidhur me hapjen e urës në Mitrovicë në këtë kohë, që mund të ndikojë në sigurinë e ushtarëve të NATO-s, përfshirë ata amerikanë. "Ne besojmë se ky rrezik rrit kërcënimin, mundësinë e dhunës dhe problemet e tjera si për komunitetin lokal, po ashtu edhe për ushtarët e NATO-s, përfshirë ushtarët amerikanë që po punojnë për ta siguruar paqen dhe sigurinë në Kosovë. Ne e marrim shumë seriozisht çdo veprim që mund të ndikojë në sigurinë dhe mbrojtjen e ushtarëve amerikanë që punojnë për ta mbështetur Kosovën. Shpresa jonë është që Qeveria do

ta dëgjojë këtë dhe do t'i marrë parasysh këto shqetësime", ka thënë ai në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". Qeveria e Kosovës ka thënë se synon të hapë për qarkullim të automjeteve urën mbi Ibrë, që ndan Mitrovicën e Jugut me shumicë shqiptare dhe atë të Veriut me shumicë serbe. Me gjithë kundërshtimin e vendeve të Quintit dhe NATO-s, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ura duhet të hapet dhe se "nuk është kundër askujt". Paralajmërimi për hapjen e urës u bë pasi autoritetet e Kosovës më 5 gusht mbyllën zyrat e Postës së Serbisë në veri, veprim që është parë nga aleatët e Kosovës si "i pakoordinuar dhe i njëanshëm". Hovenieri ka thënë se ShBA-ja

është sfiduar nga kryeministri dhe qeveria e tij në disa aspekte. "Duhet të them se cilësia e partneritetit tonë nuk është ajo që do të shpresonim të ishte në disa nga këto çështje që lidhen me mënyrën se si ai trajton veriu dhe si ai e menaxhon dialogu", ka thënë Hovenieri. Ai ka thënë se veprimet e pakoordinuara të qeverisë në veri e zvogëlojnë entuziazmin e ShBA-së për ta mbështetur Kosovën në rrugën e saj euroatlantike.

"Ju lutemi, mos e ndërmermi këtë veprim tani"

Do t'ia filloj me zhvillimet e fundit. Përse nuk është koha e përshtatshme për ta hapur urën

në Mitrovicë, për të cilën janë pajtuar edhe Kosova edhe Serbia në Bruksel?

Jeffrey Hovenier: Me të vërtetë më vjen mirë që e shtruat këtë pyetje sepse mendoj se kjo çështje është keqkuptuar. Shtetet e Bashkuara të Amerikës besojnë fuqishëm se nuk është koha për ta rihapur urën për qarkullim të automjeteve. Më lejoni të sqaroj diçka. Ne besojmë se ura përfundimisht do të duhet të hapet për qarkullim të automjeteve dhe kjo gjë, siç e thatë dhe ju, ishte pjesë e dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Është arritur një marrëveshje, por ne i kemi kërkuar qeverisë që të mos vazhdojë me këtë çështje tash për tash, dhe këtë nuk e kanë bërë vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kolegët e mi të Quintit kanë qenë me mua në një takim me kryeministrin (e Kosovës, Albin Kurti) për këtë çështje. Arsyeja pse e kërkojmë këtë është se besojmë se ka rrezik të njëmendtë që lidhet me një veprim të tillë tani, si dhe besojmë se ky rrezik shton kërcënimin e mundshëm për dhunë dhe

probleme të tjera si për komunitetin lokal, ashtu edhe për ushtarët e NATO-s, përfshirë ushtarët amerikanë të cilët po punojnë për të ofruar paqe dhe siguri në Kosovë. Dhe ne i marrim shumë seriozisht veprimet që mund të ndikojnë në sigurinë e ushtarëve amerikanë që punojnë për ta mbështetur Kosovën. Pra, kërkesa jonë drejtuar qeverisë – dhe e kemi bërë këtë bisedë që disa muaj – është: ju lutemi, mos e ndërmermi këtë veprim tani. Punoni me ne. Duam të ndihmojmë për të krijuar kushte ku diç e tillë mund të bëhet, por nuk besojmë se është koha tani.

Por, kush mund të shkaktojë dhunë?

Jeffrey Hovenier: Nuk mund të flas se kush mund të shkaktojë dhunë. Vetëm e di se kemi vlerësim që mund të ketë dhunë dhe që është reale dhe pyetja se kush mund të jetë përgjegjës për të, që është pyetje shumë e arsyeshme, nuk e mohon faktin se mund të ketë dhunë dhe rrezik të njëmendtë për komunitetin lokal dhe për ushtarët e NATO-s.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë të interesuara që në këtë çast ushtarët amerikanë të përballen me rrezik shtesë për këtë çështje.

Në reagimin tuaj ndaj mbylljes së Postës së Serbisë, ju thatë se veprimet e pakoordinuara të Kosovës rrezikojnë qytetarët e Kosovës dhe ushtarët e KFOR-it. Por, pikërisht në këtë rast, e dimë se KFOR-i ka një prani të përhershme në urë dhe KFOR-i, gjithashtu, mendon që kjo çështje duhet të diskutohet në dialogun në Bruksel. A ka mundësi që kjo çështje në një çast ta vë KFOR-in në përballje me autoritetet e Kosovës?

Jeffrey Hovenier: Nuk mund të flas se si do të reagojë Kosova në një situatë të tillë. Mund të them se KFOR-i ka qenë mjaft i qartë se e merr seriozisht edhe këtë çështje. KFOR-i ndan të njëjtin vlerësim të rrezikut që Shtetet e Bashkuara e kanë për këtë çështje dhe që ne ua kemi bërë të ditur autoriteteve të Kosovës, se hapja tani e urës për qarkullim të automjeteve do të rrisë rrezikun për ushtarët dhe kjo është arsyeja pse KFOR-i ka qenë gjithashtu shumë-shumë i qartë duke shprehur pikëpamjen se kjo duhet të bëhet vetëm në një mënyrë që e zbut atë rrezik. Por, ne nuk besojmë se planet aktuale e marrin parasysh atë rrezik.

“KFOR-i do të reagojë ndaj çfarëdo kërcënimi që do të rriste jostabilitetin në rajon”

A mund të refuzojë KFOR-i që të largohet nga ura?

Jeffrey Hovenier: Për këtë duhet të vendosë vetë KFOR-i. KFOR-i ka dhënë një varg deklaratash publike që është i gatshëm të përmbushë detyrat e tij, për të garantuar mjedis të qetë dhe të sigurt, si dhe për të mundësuar liri të lëvizjes në vend, por gjithashtu ka dalë me deklarata që qartësojnë se do të reagojë ndaj çfarëdo kërcënimi që do të rriste jostabilitetin në rajon.

Pavarësisht prej këtij qëndrimi të Quintit, Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s, kryeministri Kurti këmbëngul se ura duhet të hapet dhe se kjo nuk është kundër askujt. Këto ditë kemi parë edhe punime në urë, testime, bisedime me popullatën vendore, edhe pse shumë pak serbë kanë marrë pjesë në to. Pra, duket se kryeministri Kurti po vazhdon planin e tij, atë që prezantoi në takim para disa ditëve.

Jeffrey Hovenier: Nuk mund të flas për qëllimet e Qeverisë. E di që kryeministri më ka thënë se dëshiron t'i bëjë gjërat në bashkërenditje me bashkësinë ndërkombëtare dhe këtë e ka thënë publikisht. Porosia e bashkësisë ndërkombëtare për kryeministrin është më se e qartë se tani, në këtë çast, ne nuk e mbështesim ndryshimin e statusit të urës. Dhe, arsyeja pse nuk e mbështesim është sepse besojmë se ekziston mundësia për rritje të tensioneve dhe të dhunës, e cila rrit rrezikun për ushtarët dhe për

komunitetet lokale, përfshirë edhe për ushtarët amerikanë. Kështu ka shkuar biseda jonë. Shpresa jonë, kërkesat tona kanë qenë të sinqerta dhe të matura, por të qarta: shpresojmë që qeveria do t'i marrë parasysh kërkesat e Shteteve të Bashkuara për diçka që ne besojmë se ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e ushtarëve tanë dhe ushtarëve të NATO-s që punojnë në Kosovë. Shpresojmë që qeveria ta dëgjojë këtë kërkesë dhe t'i marrë parasysh këto shqetësime.

E nëse nuk i merr parasysh? Si do të reagojnë Shtetet e Bashkuara?

Jeffrey Hovenier: Nuk hyj në çështje hipotetike. Kosova thotë se është partnere dhe mike jona. Kosova na thotë se është vendi më proamerikan në botë, prandaj, do të shpresoja që vendi më proamerikan në botë t'i dëgjojë kërkesat specifike të qeverisë amerikane për të mos vënë në rrezik ushtarët e NATO-s, përfshirë ata amerikanë.

Por, menjëherë pas takimit me Quintin, kryeministri - kabineti doli me një deklaratë ku thuhej se ura duhet të hapet dhe, po ashtu, i kemi parë gjithë ato punime në urë. Pra, ata po vazhdojnë planin e tyre...

Jeffrey Hovenier: Mund të them vetëm se edhe ne kemi dalë me deklarata pas takimit ku i kemi shprehur pikëpamjet tona, se jemi të shqetësuar për këtë veprim në këtë moment. Sërish, në afat të gjatë, Shtetet e Bashkuara pajtohen, e mendoj që edhe partnerët tanë evropianë po ashtu pajtohen, që ura do të duhej të hapej për qarkullim të automjeteve. Kjo marrëveshje është arritur në dialog. Shrohet pyetja: si dhe në çfarë rrethanash? E, ne nuk besojmë që janë kushtet e përshtatshme pikërisht tani. Arsyeja përse nuk besojmë që janë kushtet e përshtatshme pikërisht në këtë çast është për shkak të vlerësimit tonë, të cilin e kemi ndarë vazhdimisht me autoritetet e Kosovës, se kjo gjë shton rrezikun dhe kërcënimin për popullatën lokale dhe për ushtarët e NATO-s, duke përfshirë edhe ushtarët amerikanë.

“Jemi sfiduar nga kryeministri dhe qeveria e tij”

Përse kjo urë është kaq e rëndësishme kur dihet që urat e tjera, që janë disa metra më larg, janë të hapura për këmbësorë dhe për qarkullim të automjeteve?

Jeffrey Hovenier: Mendoj se për këtë gjë duhet ta pyesni Qeverinë e Kosovës. Unë nuk kam përgjigje të mirë për të.

A e konsideroni ende kryeministrin Kurti partner tuajin? A ju konsideron ai juve partner?

Jeffrey Hovenier: Nuk mund të flas se si na konsideron ai. Mund të them vetëm se nga këndvështrimi i Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, jemi sfiduar nga kryeministri dhe qeveria e tij në disa mënyra. Në disa çështje kemi partneritet të mirë dhe të ngushtë.



Kemi punuar së bashku në disa gjëra të rëndësishme për të përmirësuar ekonominë e Kosovës dhe jemi përpjekur për ta ndihmuar vendin që të krijojë një sistem ekonomik që iu ofron mirëqenie më të mirë. Kemi arritur përparim të njëmendtë me autoritetet e shtetit të Kosovës për t'i ndihmuar institucionet mjaft të reja të qeverisë, që të jenë më efikase në punën e tyre dhe për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit. Por, për këto çështje, më duhet të them se jemi sfiduar nga kryeministri dhe qeveria e tij, dhe më duhet të them se cilësia e partneritetit tonë nuk është ajo që do të shpresonim të ishte për disa nga këto çështje që lidhen me mënyrën se si merret me çështjen e veriut dhe me atë të dialogut. Këtë nuk e them vetëm unë. Para pak kohësh, këtu ishte një nënsekretare jona e Shtetit, e cila foli për nevojën dhe shpresën tonë për bashkërenditje dhe bashkëpunim më të mirë. Jim O'Brien, ndihmëssekretari ynë për Evropën, ka folur publikisht për këtë. Ne patëm një moment të jashtëzakonshëm dhe do të marr pak kohë që ta lexoj një pjesë të deklaratës, kur hiç më larg se javën e kaluar, pas aksioneve të pakoordinuara kundër zyrave të Postës në veri, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit tha: “Jemi të shqetësuar nga vendimet e vazhdueshme të pakoordinuara të udhëheqësisë së Kosovës. Ne besojmë se ato i vënë në rrezik mundësitë që ne kemi ndihmuar që Kosova t'i krijojë. Nëse shikoni, që nga pavarësia e Kosovës, Shtetet e Bashkuara kanë mbështetur fuqimisht integrimin e saj të plotë në bashkësinë ndërkombëtare si një demokraci sovrane dhe shumetnike, por për ta realizuar këtë vizion, i cili është një vizion që ne e ndajmë, ne kemi bashkëpunuar me udhëheqësit e njëpasnjëshëm politikë të Kosovës për masat që fuqizojnë paqen dhe prosperitetin në vend, që e çojnë Kosovën përpara në rugëtimin euroatlantik. E nxisim këtë Qeveri të Kosovës që të kthehet, gjë që sugjeron se nuk jemi në atë pikë tani, në një angazhim të ngushtë dhe konstruktiv me Shtetet e Bashkuara, me BE-në, me NATO-n dhe me partnerët e tjerë ndërkombëtarë të Kosovës”.

“Shqetësohem se kah po shkon kjo...”

Sa kohë do të prisni që Kosova të kthehet? Sa kohë, më lejoni të them, do të toleroni që të sfidoheni?

Jeffrey Hovenier: E dini, Kosova është shtet sovran dhe ne e pranojmë si të tillë. Kështu që nuk e di nëse është çështje e tolerancës. Mendoj se më shumë ka të bëjë me cilësinë e partneritetit tonë. Kemi mëdyshje se sa e përkushtuar është kjo Qeveri për partneritet me ne. Kur flasim me një qeveri për gjërat që mund të bëjë të cilat shtojnë rrezikun për ushtarët tanë dhe nuk jemi të bindur se po marrim një përgjigje efektive, kjo ndikon në pikëpamjen tonë se deri në çfarë mase kjo qeveri po i merr parasysh shqetësimet tona, sa e përkushtuar është kjo qeveri ndaj partneritetit që duam të kemi.

A po shqyrtoni ndonjë pasojë?

Jeffrey Hovenier: Shikoni, shqetësohem se kah po shkon kjo. Dua të them, në afat të gjatë, Shtetet e Bashkuara duan të shohin, dhe populli i Kosovës dëshiron ta shohë Kosovën duke përparuar drejt strukturave evropiane dhe euroatlantike. Dëshirojmë ta shohim Kosovën në Këshillin e Evropës. Dëshirojmë ta shohim Kosovën në BE. Dëshirojmë ta shohim në NATO. Rruga për ta arritur këtë është duke punuar së bashku me ne, me partnerët tanë evropianë, me prijësit e BE-së, me prijësit e NATO-s. Por, vetëm një shembull. Hiç më larg se javën e kaluar, me këtë aksion të pakoordinuar kundër Postës, e patë se si BE-ja, ShBA-ja, Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Italia, të gjitha i ngritën shqetësimet e tyre. Shqetësohem se veprimet e tilla ulin oreksin dhe zbehin zotimin - jo zotimin, por entuziazmin për ta mbështetur Kosovën në rugëtimin e saj. Kosova tashmë ka humbur një mundësi të rëndësishme për anëtarësim në Këshillin e Evropës, duke mos reaguar ndaj kërkesave të partnerëve tanë evropianë, të cilët mund t'i zgjedhin kushtet që ata prisnin që Kosova t'i përmbushë për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës. Jam shumë i shqetësuar se rruga e

Kosovës drejt Bashkimit Evropian, kërkesa e saj, aplikimi aktual për statusin e anëtarësimit, zbatimi efektiv dhe i plotë i marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, që është në dobi të Kosovës, brengosem shumë se do të ketë ndikim negativ. Javën e kaluar, kolegu im gjerman foli për mënyrën sesi vetë rruga e anëtarësimit mund të vihet apo të mbahet në sirtar ose të ngrihet. BE-ja po flet për masa shtesë. Shpresoj shumë që të mos ketë masa shtesë, por kjo, në masë të madhe, varet nga Qeveria e Kosovës dhe shkalla në të cilën ajo do t'i ndalë këto lloj veprimesh për të cilat ne vazhdimisht kemi paralajmëruar, dhe do të fillojë të veprojë në partneritet me ne dhe me partnerët tanë evropianë ashtu siç e kemi kërkuar vazhdimisht të bëjë. Pajtohemi që kjo është e vështirë. Pajtohemi se ka gjëra të vështira në agjendë, por gjithashtu mendojmë se kemi një sistem dhe një proces për të ndihmuar në avancimin e Kosovës që e kërkon një bashkëpunim të tillë.

A po llobojnë Shtetet e Bashkuara për anëtarësimin e Kosovës në organizata të ndryshme apo kjo çështje është në pritje?

Jeffrey Hovenier: Nuk kam parë shumë entuziazëm në mbështetje të përpjekjeve të qeverisë tani për anëtarësime të reja në organizatat ndërkombëtare. Kemi bërë përpjekje të vërteta për Këshillin e Evropës, por Kosova pastaj nuk tregoi vullnet për të ndërmarrë hapin që partnerët e saj evropianë dhe ne ia kërkuam, që të dërgonte draft-statutin për Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Gjakatën Kushtetuese për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së tij.

Kjo nuk ka ndodhur ende.

Jeffrey Hovenier: Nuk ka ndodhur ende dhe fakti që nuk ka ndodhur, më duhet të them, e ka zbehur entuziazmin e qeverisë amerikane për t'i vazhduar këto përpjekje, përderisa Kosova nuk do ta ndërmarrë madje as këtë, sipas këndvështrimit tonë, hap mjaft të vogël dhe të hershëm në këtë proces.

Çfarë do të ndodhë nëse nuk e dërgon draft-statutin në Gjakatën Kushtetuese?

Jeffrey Hovenier: Dua të them, kjo është zgjedhje e Qeverisë së

Kosovës, por kjo do të thotë se, mendoj se shumë nga këto procese ka gjasë të ngecin. Kjo është çështje e real-politikës. Nëse doni të anëtarësoheni në NATO, nëse doni të anëtarësoheni në Bashkimin Evropian, nëse doni të anëtarësoheni në Këshillin e Evropës, duhet të keni mbështetjen e vendeve që tashmë janë anëtare dhe kemi sfidën e disa vendeve në ato institucione që nuk e njohin Kosovën siç e njohim ne si shtet sovran dhe të pavarur dhe e kanë bërë të qartë se një aspekt i mbështetjes së tyre do të varet nga përparimi në dialog dhe duke dashur të shohin Kosovën dhe Serbinë të ripozicionojnë marrëdhëniet e tyre. Nga këndvështrimi ynë, Qeveria e Kosovës nuk është angazhuar në mënyrë konstruktive në dialog në disa mënyra të caktuara. Por, mund të them të njëjtën gjë edhe për Serbinë. Kemi folur për domosdoshmërinë që të dyja vendet të punojmë shumë më shumë për t'i përmbushur të gjitha detyrimet e tyre. Por, duke qenë se e nxjerr bukën në Kosovë, si dhe meqenëse personalisht unë dhe qeveria ime institucionalisht, dëshirojmë shumë që ta shohim Kosovën duke përparuar në këtë rrugëtim dhe duke zënë vendin e saj në strukturat evropiane, shpresojmë ta shohim këtë qeveri, në vend që të përpigjet të ndërmarrë veprime që na e vështirësojnë mundësinë për të avokuar në mënyrë efektive, duke na dhënë argumente të mira në favor të anëtarësimit të Kosovës. Kjo nuk ka ndodhur ende.

“Gjendja në veri është më ndryshe sesa ishte dy apo tre vjet më parë, por...” T’u kthehemi veprimeve të qeverisë në veri. Gjatë dy vjetëve të fundit bashkësia ndërkombëtare ka reaguar shumë herë për veprimet që i ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës. Por, Qeveria po thotë se ka pasur sukses, ia ka dalë të vendosë rregull dhe rend. A besoni se ka më shumë rregull dhe rend në veri sesa dy-tre vjet më parë?

Jeffrey Hovenier: Do të thosha se gjendja në veri është më ndryshe se sa ishte dy apo tre vjet më parë. Por, nëse dëshironi ta integroni një rajon, i integroni edhe rajonin edhe njerëzit, e ajo që kam parë kohëve të fundit është mungesë e integritetit të popullatës në veri dhe përpjekje absolute, të pakompletuara për t'i tërhequr, për t'i nxitur, për t'i përfshirë ata. Le ta marrim vetëm shembullin e takimit për urën. Aty ishin shumë pak njerëz. Ata që ishin aty, e që ishin qytetarë të veriut, siç e kam kuptuar, shumica nuk ishin për hapjen e urës për qarkullim të automjeteve.

“Kurti planifikon të marrë pjesë në Konventën Kombëtare Demokratike me ftesë të Institutit Kombëtar Demokratik”

Dhe, folën për çështjet e tjera me të cilat përballen e jo për urën.
Jeffrey Hovenier: Pikërisht dhe ata janë shumë të shqetësuar. Prandaj, shpresojmë që kjo Qeveri, e cila absolutisht shprehet me fjalë të duhura se është qeveri për të gjithë qytetarët e Kosovës, të veprojë në përputhje me këtë dhe të gjejë mënyra për t'i treguar popullit se edhe ata duhet të integrohen në Kosovë, se ka përfitime të njëmendta nga integrimi dhe se kjo qeveri është e përgjegjshme ndaj brengave të tyre. Nuk kam takuar shumë përfaqësues të bashkësisë etnike serbe kohëve të fundit, të cilët besojnë se qeveria Kurti po bën përpjekje të suksesshme për të treguar ndjeshmëri dhe shqetësim rreth çështjeve që janë në mendjen e bashkësisë etnike serbe në Kosovë.

E përmendët se keni pasur sfida nga kjo qeveri. Por, dje, pamë raportime në media që kryeministri Kurti mund të marrë pjesë në Konventën Kombëtare Demokratike në Çikago. A mund ta konfirmoni këtë?
Jeffrey Hovenier: Sa e di unë, kryeministri Kurti planifikon të



marrë pjesë në Konventën Kombëtare Demokratike me ftesë të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI – National Democratic Institute). Por, të jemi të qartë, kjo nuk është ftesë nga Qeveria amerikane. Partia Demokratike është një parti politike në Shtetet e Bashkuara. NDI-ja është krah i Partisë Demokratike që punon në ndërtimin e partive dhe institucioneve demokratike jashtë vendit. Pra, kryeministri është ftuar nga NDI-ja, besoj në cilësinë e tij si kryetar i një prej partive të Kosovës, ashtu siç NDI-ja i ka ftuar edhe kryetarët e partive tjera të Kosovës. Por, kjo nuk është ftesë nga qeveria amerikane.

Në fund, dëshiroj t’ju pyes pak për Banjskën. Po i afrohemi përvjetorit të parë të Banjskës. Organizatori kryesor, Milan Radoičiq, është ende i lirë, supozohet në Serbi. Edhe sa kohë do të presin Shtetet e Bashkuara që Serbia ta arrestojë Radoičiqin dhe që ai të përballët me akuza?
Jeffrey Hovenier: Mendoj se Shtetet e Bashkuara kanë qenë mjaft të qarta lidhur me pritjet tona që të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në atë krim të tmerrshëm të japin llogari. Këtë e

kemi thënë publikisht. Dhe, natyrisht, pjesë e diplomacisë sonë me Serbinë kanë qenë edhe pritjet tona që z. Radoičiq dhe autorët e tjerë të kësaj vepre kriminale të mbajnë përgjegjësi. Kjo vazhdon të jetë pjesë e bisedës sonë dhe shpresojmë ta shohim të ndodhë së shpejti. Dëshiroj të vë në pah se sipas mendimit tim, Kosova mund të ndihmojë për këtë. Sa e di unë dhe zyrtarët serbë kanë folur për këtë, ata kanë parashtruar kërkesë zyrtare përmes kanaleve zyrtare për ndihmë juridike reciproke, që t’ju sigurohen provat që iu duhen për ta ndjekur penalisht z. Radoičiq, të cilat i kanë autoritetet kosovare. Sërish, në baza politike, do të shpresoja që Qeveria e Kosovës t’i përgjigjet kësaj kërkesë, sepse dëshironi që të siguronin që të ketë ndjekje penale dhe që z. Radoičiq, si dhe të tjerët që ishin të përfshirë, të japin përgjegjësi për veprën e tyre kriminale.

A ka rezultate nga hetimet? Ish-ndihmësi i sekretarit të Shtetit, Escobar, e ka përmendur se ka mundësi që sulmi ka pasur lidhje financiare dhe organizative me shtetin e Serbisë.
Jeffrey Hovenier: Nuk kam gjë për

të shtuar për këtë.
A mendoni se mungesa e përgjegjësisë për Banjskën e ushqen këtë narrativë se Perëndimi po e qetëson Serbinë duke mbajtur qëndrim më të butë për shkak të interesave gjeopolitike, për ta pasur Serbinë në krah të saj, duke siguruar që Serbia të jetë në Bruksel e jo në Moskë.
Jeffrey Hovenier: E dini, mendoj se Shtetet e Bashkuara kanë qenë mjaft të qarta se presim që Kosova dhe Serbia t’i përmbushin disa standarde. Dhe, mendoj se kemi qenë - sërish, unë punoj në Kosovë për bukën e gojës - prandaj e tëra që mund të them është se besoj se Ambasada e ShBA-së në Beograd është mjaft e angazhuar në përpjekjet për të siguruar që Serbia t’i përmbushë gjërat që vetë ka thënë se do t’i kryejë. Dhe, kjo përfshin që z. Radoičiq dhe autorët e tjerë të një krimi, të japin llogari për atë krim. Këtu, gjithashtu, përfshihet çështja që Serbia t’u përmbahet dhe t’i përmbushë të gjitha detyrimet e saj që i ka marrë në dialog, ashtu siç po bëjmë ne këtu.

Kurti: Hapja e urës së Ibrit nuk është kundër askujt, aq më pak kundër partnerëve tanë

PRISHTINË, 14 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se qeveria e tij do t’i vazhdojë konsultimet dhe koordinimet me partnerët e Kosovës në lidhje me rihapjen e urës mbi lumin Ibër në veri. “Ne do t’i vazhdojmë konsultimet dhe koordinimet me partnerët tanë. Hapja e urës nuk është kundër askujt, veçmas kundër partnerëve ndërkombëtarë”, ka thënë Kurti në mbledhjen e qeverisë. Rihapja e urës së Ibrit për qarkullim edhe të automjeteve, e cila i ndan shqiptarët në jug dhe serbët në veri, është kundërshtuar nga bashkësia ndërkombëtare dhe nga serbët lokalë. Vendet e Quintit, ShBA-ja, Britania, Franca,

Gjermania dhe Italia, e kanë quajtur të njëanshëm vendimin e Qeverisë së Kurtit për rihapjen në këtë kohë. BE-ja ka bërë thirrje që çështja e urës të diskutohet në dialog me Serbinë. “Me komandantin e KFOR-it biseduam për hapjen e urës kryesore mbi Ibër në Mitrovicë, të cilën ne e konsiderojmë si një gjë të drejtë të nevojshme dhe të dobishme për të gjithë”, ka thënë Kurti, duke iu referuar takimit të djeshëm me Ozkan Ulutas. Pas takimit të së martës në mes të Kurtit dhe Ulutasit, KFOR-i ka thënë se është thelbësore që të gjithë aktorët të përmbahen nga deklaratat dhe veprimet e njëanshme që mund të krijojnë tensione.



Korbat e “patriotizmit”



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Ura e Rambujesë mbi lumin Ibër: Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Rambujesë dhe asaj në Kumanovë, puna e parë që e bënë xhandarët francezë ishte vendosja në urën mbi lumin Ibër duke e ndarë qytetin në dy pjesë, të veriut dhe të jugut. Vendimi për urën ishte politik, politik është edhe sot. Shqiptarët nuk kanë pasur mundësi të bëjnë asgjë përveç se të luftojnë kundër KFOR-it dhe strukturave paralele apo forcave policore dhe paramilitare të Serbisë që e kontrollonin veriu. Natyrisht se këtë nuk e bënë sepse nuk kishin fuqi e as mandat. Pas kësaj ura përfundimisht u mbyllë dhe përdoret dhe po përdoret për qëllime politike. Këta që asgjë nuk kishin bërë për luftën dhe çlirimin e vendit përgjegjës në për mbylljen e urës e adresuan te Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Agim Çeku dhe udhëheqësit politikë dhe ushtarakë të UÇK - së. Sa të pamoralshëm, qyqarllëkun e tyre dhe kolaboracionizmin me Serbinë e mbulonin me "përgjegjësinë" e atyre që e çliruan vendin, pa pyetur për çmimin që duhej paguar. Ura po keqpërdoret edhe nga shqiptarët sikur edhe nga serbët në kohën kur vendimmarren për hapje të urës e kanë ekskluzivisht ndërkombëtarët. Mitrovica, si qyteti më problematik në Kosovë e preku fundin e pusit të mjerimit kur për kryetar e zgjodhën një injorant enciklopedik, Agim Bahtirin që tërë mashtrimin e mbështolli me hapjen e urës. Nuk e hapi e as që do ta hapte edhe për 500 vjetet e ardhshëm. Albin Kurti u zotua fuqishëm se do ta shtrijë sovranitetin në Veri të Kosovës e që deri më sot nuk e ka bërë apo e ka bërë përmes fotoshopit. Sovranitetin nuk e shtrinë Policia Speciale apo ekskluzivisht kjo polici. Gjendja në veri e që

përkufizohet si qetësi relative nuk është rezultat i politikave të mençura të Albin Kurtit por është rezultat i bizantinizmit politik të Aleksandar Vuçiqit dhe dinakërisë perfekte që po e zbaton. Për këtë sot, një Serbi kriminale e kemi faktor stabiliteti në Ballkan e që po pranohet nga ndërkombëtarët kurse një Kosovë të dhunuar nga kjo Serbi po e trajtojnë si pengues të proceseve demokratike dhe paqes, gjithashtu nga ndërkombëtarët. Çështjen e Kosovës jashtëzakonisht shumë e kanë dëmtuar Barak Obama dhe Xhoe Bajden duke ua imponuar Gjykatën Speciale Raciste sikur edhe Angela Merkel që gjë të hajrit nuk ka bërë për Kosovën në ndërkohë që Serbinë e ka rehabilituar politikisht sikur që e ka fuqizuar shumë ekonomikisht. Edhe Sholci, pas zgjedhjeve të fundit i defaktorizuar politikisht, po vazhdon ta fuqizojë Serbinë dhe Vuçiqin kurse Albin Kurtit i ka vendosur lakun në fyt. Se kush e ka pushtetin real në veri të Kosovës treguan zgjedhjet e fundit lokale, Albini veç sa nuk ua preu kërthizën duke i lutur të dalin në zgjedhje kurse Vuçiqit iu deshën dy - tre minuta që t'i bind serbët të mos marrin pjesë në zgjedhje. Albini mund ta veshë xhurdinë e Vuk Karaxhiqit apo kamillavkën e Amfillohije Radoviçit dhe ta çajë gurmazin duke folur në gjuhën serbe por serbët nuk i besojnë. Për bindjen time dështimi më i madh deri më tani i Albinit është pikërisht Veriu i Kosovës. Muskujt sovranist i ka të rrejshëm, potencën politike po e mbanë të gjallë përmes kallauzit të quajtur Bashkësi e komunave serbe, zotimet për të cilën e ka pranuar me Marrëveshjen e Brukselit dhe aneksin e Ohrit që, pa asnjë dyshim janë gozhda në arkemortin e Kosovës, si shtet unitar, sovran

dhe i pavarur. Pas kësaj marrëveshje Kosova, ose do të ndahet, ose do të bëhet si Bosnja dhe Hercegovina. Marrëveshja e Brukselit dhe aneksi i Ohrit, pa asnjë dyshim janë tradhti politike dhe kombëtare si dhe dhunim i integritetit territorial dhe shtetëror. Kështu sigurisht nuk mendojnë mercenarët Surroi dhe Weller e as këta trutharët e VV -së, në me krye greken Mihali. Aq ju bënë këtyre për Kosovën, mos kanë bërë mund, derdhur djersë dhe gjak për Kosovën. Kurrë dhe asnjëherë, e kanë bërë dhe po e bëjnë të kundërtën duke i shërbyer Serbisë. Hapja e urës po përdoret si shkas për formim të Zajebnicës, jo se po vdesin për sovranitet. Nëse i analizoni personat që shëtisin mbi urë dhe pshurrin, nga frika, nën urë, nuk ka asgjë nga kjo hapje. Ky grup që po e teston qëndrueshmërinë e urës, që po e ngjyrosin urën, që po pshurrin në vilën e Radojçiqit, nuk ka dhënë asnjë kontribut për lirinë e Kosovës. Janë dezertorë të luftës dhe përfitues të paqes. Janë dhunues të Policisë së Kosovës, kanë dërguar materiale dhe kanë dëshmuar në Gjykatën Speciale Raciste në Hagë. I urrejnë të burgosurit politikë, e urrejnë luftën dhe UÇK - në. Janë të pabesë, injorantë dhe të pamoralshëm. Albini që e kam njohur nuk është dashur të jetë në këtë grup dhe me këtë grup. Kurrë dhe asnjëherë. Por,duket qartë se, ose ka ndryshuar Albini, ose kam rrjedhur unë. Albini nuk e hapë urën pa lejen e ndërkombëtarëve përkundër manovrimeve mashtruese që po i bënë. Nuk ka k.e, guxim dhe vullnet ta humbë pushtetin shkaku i urës. Urën po e përdorë si kuti votimi, jo si shtrirje të sovranitetit. Sikur që po e përdorin rastin e Astrit Deharit, Arbnor Deharit, Mon Balajt dhe

Arben Xheladinit. Këtyre eunuhëve moralë as që iu bëjnë përshtypje tragjeditë personale dhe familjare për të ardhur në pushtet dhe mbetur në pushtet. Janë në gjendje edhe për shumë viktima të tjera vetëm për një bythë karrige. Po harrojnë se drejtësia tokësore të cilën e kanë kapur deri në përdhunim, asnjëherë nuk është mbi drejtësinë hyjnore. Pra, asgjë nuk ka nga hapja e urës, nëse si kundërpeshë nuk jepni diçka shumë më të vlefshme. Ose, nëse vërtet e kanë përmjëmend, le ta hapin urën, të shkojnë deri te Molla e Kuqe dhe mos të kërkojnë ndihmë apo mëshirë nga KFOR dhe miqtë ndërkombëtarë. Në këtë rast do të jem me ta, pa asnjë dyshim. Mirëpo as në variantin më optimist dhe me alkiminë më të përsosur të Paulo Koelhos nuk është arritur që m..i të bëhet barut. Po, çdo rregull ka përjashtime, thonë optimistët.

Mirësia ka kufij, poshtërsia jo: Udhëheqësit e luftës çlirimtare, themeluesit e UÇK -së, shpallësit e pavarësisë, bartësit e posteve më të larta shtetërore, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, me shokë po mbahen peng në Gjykatën Speciale Raciste në Hagë me kontributin e Serbisë dhe një pjesë të politikës kosovare. Se Serbia angazhohet për dënimin e tyre, nuk është çudi, pse edhe disa shqipfolës në Kosovë e kanë të njëjtin qëllim, gjithashtu nuk është çudi, pushteti mbi të gjitha. Kur Gjykata Raciste Speciale merr vendim për vazhdimin e masës së paraburgimit, thirret në burime të nipit politik të Arkanit dhe vjedhësit të parave të Bacës Adem Demaçi e që marrin miliona euro nga të gjitha pushtetet për këtë. Së fundi, në emër të moszbardhjes së rastit Astrit Deharit, u akuzuan të gjitha institucionet e pushtetit dhe sigurisë në Kosovë duke përmendur edhe emra të përveçëm, jo për Astritin por për t'ua rënduar gjendjen pengjeve në Hagë. Këtu ishte qëllimi, rasti Dehari është sqaruar nga ekspertizat ndërkombëtare. Po e lë mundësinë që për këtë rast të shkruaj sepse jam munduar ta respektoj dhimbjen për këtë tragjedi personale dhe familjare, prandaj edhe kam heshtur. Jam sjell ekstremisht në mënyrë njerëzore me krijesa që vetëm anatominë e kanë njerëzore. Disa "mbrojtës" të Astrit Deharit, vendin e kanë në burg. Kaq kësaj radhe. Shumë e shumë herë kam vizituar fatkëqijtë Dehari me të cilët aq shumë dhe aq poshtërsisht po manipulohet.

Vota nga varri: LDK edhe sot shkonë te Varri, sidomos para zgjedhjeve. Aty e fillon fushatën. Paradoksalisht, më shumë vota fitojnë nga varri, se nga puna që e

bëjnë. Tash, në prag të zgjedhjeve qenka shpallur një tender për rregullimin e Varrit në vlerë fillestare prej 50,000 eurove. Jashtë çdo logjike normale. Po, duhen votat, edhe nga Varri, sidomos nga Varri. Duhet që Ibrahim Rugove të lihet qetë nga manipulimet politike sepse këta, as që e kanë dashur e as që e duan. Edhe varri i Astrit Deharit po shndërrohet në kuti votimi. Nga ata që pikërisht i hapën varrin.

A është patriot Ramush Haradinaj: Jam i bindur se është dhe se nëse e kërkon rasti përsëri lufton. Po kështu nuk po mendon Danica Marinkoviç e VV - së, Dejona Mihali. Me deklaratën e fundit Danica - Dejona ia bën me sy Gjykatës Speciale Raciste. E pritshme.

Konvertimet e paguara dhe antikombëtare: Besimi është diçka personale, madje shumë personale. Edhe konvertimi duhet të jetë diçka personale, krejtësisht personale. Te ne është e kundërta, konvertimi është manipulim politik, dhunim i privatësisë dhe korrupsion shpirtëror. Me çfarë pompoziteti po përcillen këto konvertime, diçka e madhe dhe e orkestruar qëndron prapa. Pas çdo konvertimi kemi deklarata për publik që kryesisht e kanë urrejtjen ndaj besimit tjetër duke e ndërlidhur me patriotizëm. Patriotizëm të leshit. Merreni me mend kur thuhet se në. ...“në kishën katolike shqiptare në Llapushnik filan Hasani u bë Pjetër... Çfarë idiotizmi. Referuar kësaj duhet të shkruajmë, në xhaminë myslimane shqiptare... etj. O hajvanë, duhet ta keni të qartë se identiteti kombëtar nuk është i njëjtë dhe nuk kushtëzohet nga identiteti fetar. Identiteti kombëtar është mbi çdo besim. Mos e ndizni zjarrin e panevojshëm, për llogari të djallit. Çdonjëri duhet të jetë i lirë të besoj në atë që beson. Pikë. Lajmërim nga opozita kosovare: Shpesh ndodh që një parti opozitare të thërras konferencë për media, pa treguar arsyen dhe temën. Në rrethana aktuale mendoj se të tre partitë opozitare në Kosovë duhet ta thërrasin një konferencë të jashtëzakonshme me vetëm një çështje: OPOZITA KOSOVARE KA VDEKUR. Dhe vërtet ka vdekur, që nga dita e parë kur pozita erdhi në pushtet. Në rrethana normale opozita krijon tema edhe nga situatat e pamundura, në rrethanat tona opozita nuk është në gjendje të shënojë edhe në gol të zbrazët të pozitës. Thuaja çdo ditë pozita ka krijuar raste për opozitën. Por, a reagon... i vdekuri. Amerikanët nuk votojnë për opozitën sikur që nuk e rrëzojnë Albini. Votuesit real janë në Kosovë dhe diasporë. Aty kërkon votat.

PTK-ja hap pikat në katër komunat veriore

PRISHTINË, 14 GUSHT - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Elbert Krasniqi, ka bërë me dije se pas mbylljes së degëve të Postës së Serbisë në veri, ajo e Kosovës i ka hapur pikat e saj dhe ka filluar shërbimet postare atje. Përmes saj, Krasniqi ka thënë se qytetarët e Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokit, Leposaviqit dhe Zveçanit mund t'i kryejnë pagesat e ndryshme institucionale. Pas mbledhjes së qeverisë, ai ka njoftuar se MAPL-ja ka nënshkruar marrëveshjen e

mirëkuptimit me shoqatën "Jetimët e Ballkanit" për bashkëfinancimin e shtëpive në këto katër komuna. "MAPL të hënën ka nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit me shoqatën 'Jetimët e Ballkanit' për bashkëfinancimin e shtëpive në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan. Ky bashkëfinancim vjen pas numrit të lartë të aplikuesve. Sipas marrëveshjes, rreth 102 shtëpi do të ndërtohen nga MAPL dhe 100 shtëpi të tjera nga shoqata. Përveç kësaj,

janë funksionalizuar zyrat kadastrale komunale që qytetarët atje të mos kenë telashe me pronat. Ndërsa që bizneset të mund të regjistrohen e përfitojnë nga masat mbështetëse të qeverisë kemi hapur zyrat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë. Posta e Kosovës ka hapur pikat e saj në katër komunat. Përmes tyre ajo po ofron shërbime postare si dhe të pagesave për regjistrimin e automjeteve, dënimet në trafik, dokumentet personale", ka thënë Krasniqi.



Ndahen 4 milionë euro për ndërmarrjen "Trepça"

PRISHTINË, 14 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka ndarë katër milionë euro për pagat e minatorëve të "Trepçës" të cilët nuk i kanë marrë pagat që tre muaj. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë, tha se ky vendim është bërë për ta mbështetur ndërmarrjen publike, e cila nuk ka arritur t'i sigurojë pagat nga xehet e nxjerra. Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se "Trepça" ka "tepër shumë punëtorë mbi tokë për xehet e pakta të nxjerra nga nëntoka". "Për ndërmarrjen publike 'Trepça' do të ndajmë katër milionë euro dedikuar për mbështetje të 'Trepçës', në

mënyrë që të tejkalohet kriza aktuale ku ndërmarrja nuk ka arritur t'i sigurojë pagat nga xehet e nxjerra. Duket se ka tepër shumë punëtorë mbi tokë për xehet e pakta të nxjerra nga nëntoka", ka thënë Kurti. Në "Trepçë" punojnë gjithsej 1 200 minatorë, derisa paga mesatare e tyre është 740 euro. Menaxhmenti i "Trepçës", më 31 korrik, mosekzekutimin e pagave e ka arsyetuar me mungesë të mjeteve financiare dhe rënie të prodhimit. Në një situatë të ngjashme, minatorët e "Trepçës" e kanë gjetur veten disa herë edhe gjatë vitit të kaluar. Në fund të muajit tetor të vitit

2023 për dhjetë ditë me radhë ata kishin qëndruar në grevë brenda minierës pikërisht për shkak të mosrealizimit të pagave dhe ankesave për kushtet e punës. Produktet kryesore që Trepça prodhon janë koncentratet e plumbit dhe zinkut me përmbajtje të argjendit, arit dhe elementeve të tjera. Miniera e Stantërgut, që gjendet në rajonin e Mitrovicës, është vendburimi kryesor i nxjerrjes së xehes. Kompleksi metalurgjik "Trepça" është shoqëri aksionare dhe 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, kurse 20 për qind janë të punonjësve të kësaj ndërmarrjeje.



Peci: Farmerët që shkaktojnë zjarrëvenie të qëllimshme do të përjashtohen për 3 vjet nga subvencionet dhe grantet



PRISHTINË, 14 GUSHT - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka thënë se kushdo nga fermerët që shkakton zjarrëvnie të qëllimshme në parcelat e punueshme, do të përjashtohet në programet e ardhshme për tri vitet e ardhshme në aspektin e subvencionimit të granteve. Këtë deklaratë Peci e ka dhënë pas mbledhjes së qeverisë në një konferencë për medie. "Kushdo që shkakton zjarrëvnie të qëllimshme në parcelat e punueshme do të përjashtohet në programet e ardhshme për tri vitet e ardhshme në aspektin e subvencionimit të granteve. Jemi në koordinim me ministrinë përkatëse dhe me inspektorët e mjedisit dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme", ka thënë Peci.

Më tutje, Peci ka thënë se djegia e hamulloreve është e dëmshme pasi, sipas tij, ndikon edhe në ndotjen e mjedisit. "Zjarrëvnia është e kundërligjshme, është e dënueshme, varfëron tokën dhe shkakton dëme të pakthyeshme në aspektin mjedisor dhe material. Djegia e hamulloreve është e dëmshme sepse shkakton efekte negative, ndikon në ndotjen e mjedisit dhe në aspektin e florës dhe faunës. Në shumë raste po rrezikohen edhe pronat afër zjarreve. Personat e papërgjegjshëm po ndezin hamulloret duke menduar se u lehtësohet puna në bujqësi. Por është pikërisht e kundërta, sepse kjo dukuri shkakton mikroorganizma dhe materiale ushqyese të dobishme në aspektin e prodhimit bujqësor", ka thënë Peci.

ASK-ja: Rritet indeksi i qarkullimit të industrisë

PRISHTINË, 14 GUSHT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka njoftuar se është rritur indeksi i qarkullimit të industrisë. "Në muajin janar të vitit 2024 indeksi i qarkullimit në sektorët e industrisë kishte rritje për 2.5 për qind krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (janar 2023)", ka njoftuar ASK-ja.

Ndërsa sipas ASK-së, ulje kishte në sektorin e industrisë nxjerrëse për -19.24 për qind. "Në muajin janar të vitit 2024 indeksi i numrit të të punësuarve në sektorin e furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ujë dhe avull të kondicionuar kishte rritje për 2.81 për qind, ndërsa ulje kishte në sektorin e industrisë

nxjerrëse (minierat dhe guroret) për -10.9 për qind. Në muajin janar të vitit 2024 indeksi i fondit të pagave dhe mëditjeve kishte rritje në sektorin e industrisë përpunuese për 18.81 për qind, ndërsa rënie kishte në sektorin e industrisë nxjerrëse (minierat dhe guroret) për -9.52 për qind", ka njoftuar ASK-ja.



Qendra është rikthyer

... dhe mund t'i mposhtë populizmat



Rruga e Tretë e Tony Blairit, por edhe realizmi i ish-kryebashkiakut të Nju Jorkut, Bloomberg, plus përpjekjet franceze dhe italiane: të gjitha shenjat se ka hapësirë. Dhe do të jetë sërish vendimtare nëse ajo gjen udhëheqje (dhe guxim)

“Unë kurrë nuk i kam dhënë shumë rëndësi etiketave. Kqm punuar ngushtë dhe në mënyrë produktive me demokratë, të pavarur dhe republikanë. Mendoj se nuk më dëmtoi që isha demokrat, republikan dhe i pavarur. Asnjë parti nuk ka monopol mbi idetë e mira”, thotë Michael Bloomberg. “Udhëheqësit e qendrës mund të tregojnë pavarësi nga platformat partiake dhe kështu të fitojnë besimin e votuesve: është një nga avantazhet e mëdha të të qenit në qendër”. Fjalët e ish-kryebashkiakut të Nju Jorkut, i cili në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020 kishte investuar (pa sukses) gjysmë miliardë dollarë për të fituar kandidimin e Demokratëve, mund të duken anakronike në këtë epokë populizmi dhe polarizimi, e dominuar nga thirrmat sociale që e vështirësojnë ndërtimin e konsensusit rreth pozicioneve të moderuara. Megjithatë, ka nga ata që argumentojnë se një vëmendje e rikthyer tek qendra e spektrit politik mund të jetë busull për

lundrimin në ujërat e trazuara të kohës sonë, një kohë e mbytur nga konfliktet, ndryshimet klimatike dhe pabarazitë ekonomike. Kështu shkruan Yair Zivan, këshilltar i ish-kryeministrit centrist të Izraelit, Yair Lapid, tani në opozitë, në librin e tij “The Center Must Hold”. Zivan thekson se centrizmi është një forcë thelbësore politike dhe për të shpjeguar rëndësinë e tij, ai mbështetet në fjalët e disa prej centristëve më të njohur të kësaj epoke: vetë Bloomberg, por edhe Matteo Renzi dhe Sandro Gozi në Itali dhe, padyshim, Tony Blair, i cili në vitin 1996 me Rrugën e Tretë dukej se kishte hapur një epokë të re për centrizmin. Ish-kryeministri britanik ishte arkitekti i “New Labour”, një vizion i rinovuar dhe i moderuar i Partisë Laboriste, i cili kombinoi politikën sociale progresive me menaxhimin e kujdesshëm ekonomik dhe që i dha atij konsensus të gjerë global. Deri në atë pikë sa The Guardian shkroi: “Blair e ka bërë të ftohtë centrizmin”. Në mënyrë më

pragmatike, ish-kryeministri i Downing Street e ka centrizmin jo vetëm një domosdoshmëri politike,” shkruan Economist, “por një përgjegjësi morale për të ruajtur demokracinë dhe stabilitetin social. Partitë e qendrës duhet të demonstrojnë se mund të ofrojnë stabilitet dhe ndryshim, duke siguruar dhe frymëzuar në të njëjtën kohë votuesit.”

Sloganet

Shkurt, sfida e centristëve bashkëkohorë është e vështirë: duhet t'i rezistojnë tundimit për të ndjekur parullat e lehta të populistëve, duke ruajtur në të njëjtën kohë aftësinë për të folur me zemrën e elektoratit. Kjo është paksa si ajo që Joe Biden u përpoq të bënte në Shtetet e Bashkuara, i përshkruar shpesh si një centrist i moderuar, i aftë për të gjetur një kompromis midis dy palëve të barrikadës politike, ai u përpoq të merrej me krizat e mëdha që ndeshi kur hyri në Shtëpinë e Bardhë – në veçanti ato klimatike dhe ekonomike – me Build Back Better, planin ambicioz që u bë ligj në nëntor 2021, i cili premtoi investime masive në energjinë e rinovueshme duke mbajtur një sy te punëtorët në sektorët tradicionalë. Qasja e administratës Biden në fund reflekton filozofinë e mbështetur

nga Zivani: kërko progres, por pa lënë pas askënd. Tani, shkruan New York Times, «për Kamala Harris sfida do të jetë pikërisht ajo e mbajtjes së koalicionit demokrat të bashkuar pa e tjetërsuar qendrën». Është kjo edhe receta e Keir Starmer, i cili i ktheu laburistët në qeveri pas 14 vjetësh dominimi të pandërprerë të konservatorëve: duke u çliruar nga histeria ideologjike dhe ofruar zgjidhje pragmatike. “Ne nuk mund të vazhdojmë të flasim gjithmonë për të njëjtat, probleme pa i zgjidhur ato”, tha dikur Renzi, themeluesi i Italia Viva, i cili në Itali punoi për të thyer modelin e vjetër djathtas-majtas dhe u përpoq të manovrojë nga qendra. Në Francë, Emmanuel Macron e ka bërë “en même temps” – përpjekjen për të pajtuar kërkesat e ndryshme duke kapërcyer ndarjet tradicionale – busullën e tij politike. Megjithatë, gjetja e ekuilibrit të duhur nuk ka qenë e kollajtë dhe këtë vit presidenti ka arritur në pikën e llogaridhënies. Francezët u hodhën djathtas, në zgjedhjet europiane dhe në raundin e parë të zgjedhjeve legislative, por në raundin e dytë, u kthyen fort majtas dhe, në fund, u gjendën në qendër. Kjo sepse qendra, shkruan Zivan në librin e tij, «është e vetmja forcë e aftë për të ndërtuar koalicione të gjera dhe të qëndrueshme për të

përballuar sfidat globale. Pa qendrën, ne rrezikojmë të mbetemi të paralizuar mes ekstremizmave”. Siç argumentojnë Renzi dhe Gozi, «centrizmi është bastioni i fundit kundër ekstremizmit: ai synon të bashkojë më shumë aktorë politikë dhe të nxisë një kulturë kompromisi. Në këtë mënyrë ne mund të kapërcejmë ndarjet tradicionale që nuk korrespondojnë më me sfidat dhe nevojat e shoqërive tona”.

Reforma

Ajo që nevojitet është një “centrizëm i guximshëm”, shkruan Zivan, një projekt i aftë të propozojë reforma të guximshme duke ruajtur një qasje pragmatike. Nëse nga njëra anë polarizimi, fragmentimi i informacionit dhe sfidat globale e komplikojnë zhvendosjen në qendër, nga ana tjetër mund të përfundojnë duke e bërë të nevojshme: mund të shndërrohet në një forcë të aftë për të kundërshtuar dezinformimin dhe për të promovuar një debat të bazuar në fakte. Në fund të fundit, siç shkruan opinionisti i New York Times, Tom Friedman, «qendra nuk ka vdekur. Thjesht pret liderë të aftë për ta rishpikur atë për shekullin e 21-të”. / bota.al



KB Prishtina rikthen Daniel Lekndreajn

PRISHTINË, 14 GUSHT - KB Prishtina ka vazhduar përforcimet cilësore për sezonin e ri në Superligë. Skuadra nga kryeqyteti ka për synim ta rikthejë titullin kampion dhe ka bërë disa përforcime. I fundit që është bashkuar me klubin bardhekaltër është basketbollisti shqiptar Daniel Lekndreaj. Për Lekndreajn është një rikthim në klubin kryeqytetas, pasi ai edhe më parë ka veshur fanellën e Prishtinës. Klubi prishtinas ka transferuar edhe Bardh Istrefin, Jon Ismajli, Rashad Williams, Jalen Moore dhe Damiree Burns.



Ademi takoi presidentin e ri të Federatës Turke, Ibrahim Haciosmanoglu



VARSHAVË, 14 GUSHT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka takuar sot në Varshavë presidentin e ri të Federatës së Futbollit të Turqisë, Ibrahim Haciosmanoglu. I pari i FFK-së po qëndron në kryeqytetin e Polonisë me ftesë të presidentit të UEFA-s për ndeshjen e Superkupës së Evropës ndërmjet Real Madridit dhe Atalantas. Gjatë këtij takimi, presidenti Ademi e uroi Haciosmanoglu për zgjedhjen e tij në këtë post të rëndësishëm dhe i dëshiroi shumë suksese dhe punë të mbarë në udhëheqjen e futbollit turk. Ai theksoi se Haciosmanoglu është një lider i vendosur dhe këmbëngulës në arritjen e qëllimeve, me një njohuri të thellë për futbollin turk dhe atë të rajonit. Presidenti Ademi shprehu përkushtimin e tij për ta vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Federatën e Turqisë, të cilën Haciosmanoglu e mirëpriti dhe theksoi angazhimin e tij për forcimin e bashkëpunimit rajonal. Sipas njoftimit të FFK-së, i pari i futbollit turk shprehu gatishmërinë për ta vazhduar afërsinë dhe bashkëpunimin e ndërsjellë me Federatën e Futbollit të Kosovës, duke shkëmbyer përvoja dhe ide për përmirësimin e futbollit në rajon. “Në përputhje me këtë angazhim, presidenti Haciosmanoglu e ftoi presidentin Ademi për të diskutuar për projektet dhe nevojat e federatës së Kosovës. Në të njëjtën kohë, i pari i FFK-së i bëri atij ftesë për ta vizituar Kosovën, të cilën ai e pranoi me kënaqësi dhe theksoi se këtë vizitë do ta realizojë gjatë turit të tij në federatat e rajonit me qëllim të forcimit të bashkëpunimit rajonal në futboll. Presidenti Ademi dhe homologu i tij Haciosmanoglu në këtë takim qartësuan se Kosova dhe Turqia ndajnë një miqësi të ngushtë, me shumë gjëra të përbashkëta dhe se do të punojnë ngushtë për një të ardhme më të ndritur”, thuhet në njoftimin e FFK-së.

FBK-ja shpall konkurs për organizimin e Superkupës

PRISHTINË, 14 GUSHT - Federata e Basketbollit të Kosovës ka shpallur konkurs për organizimin e Superkupës së Kosovës. Superkupa do të zhvillohet nga 7 deri 11 shtator të këtij viti. Tashmë ky institucion ka paraqitur edhe kriteret e nikoqirit: Konkursi do të jetë i hapur deri më 21 gusht. Federata e Basketbollit ka njoftuar se të drejtë konkurrimi kanë të gjithë personat juridikë që përmbushin kushtet e këtij konkursi dhe dispozitat e parapara në Udhëzuesin për Organizim të Superkupës së Kosovës - Meshkuj. FBK-ja ka njoftuar se disa nga kushtet që duhen të përmbushen për të konkurruar për organizimin e këtij eventi janë: “Të mos ketë obligime të pakryera ndaj FBK-së, të sigurojë kushte për zhvillimin e ndeshjeve sipas rregullave të lojës së FIBA-s, t’i sigurojë medaljet, kupat dhe trofetë për fituesit dhe finalistët e Kupës në të dyja konkurrencat, dizajnin e të cilave e përzgjedh FBK-ja, t’i mbulojë shpenzimet për personat zyrtarë për të gjitha ndeshjet e Superkupës, t’u përmbahet në përpikëri dispozitave të Udhëzuesit për Organizim të Superkupës Kosovës për marketing në palestër dhe në transmetime televizive, të sigurojë prani të mjaftueshme të forcave policore dhe pjesëtarëve të sigurimit privat në të gjitha ndeshjet e Superkupës, t’u përmbahet dispozitave të tjera të Udhëzuesit për Organizim të Superkupës, të nënshkruajë kontratë me FBK-në ku do të specifikohen detajet e organizimit si dhe obligimet e të drejtat e palëve”.



Albin Berisha transferohet te Hansa Rostock

ROSTOCK, 14 GUSHT - Sulmuesi Albin Berisha ka kompletuar transferimin nga Petrolul Ploiesti te Hansa Rostock. Nga Rumania në Gjermani. Albin Berisha ka ndryshuar ambient pas vetëm gjashtë muajve të kaluar në Superligën e Rumanisë. Të mërkurën është konfirmuar transferimi i tij te klubi i njohur Hansa Rostock, i cili bën gara në Bundesliga 3. Vetë faqja zyrtare e klubit gjerman që ka konfirmuar transferimin e ish-yllit të Ballkanit. “FC Hansa Rostock ka nënshkruar me një tjetër nënshkrim të ri, Albin Berisha. Sulmuesi vjen nga Kosova dhe po zhvendoset në bregun e Detit Baltik nga klubi rumun i Superligës, Petrolul Ploiesti, për të cilin luan që nga shkurti i vitit 2024”, thuhet në njoftim. Klubi gjerman ka njoftuar se Berisha do ta mbajë fanellën me numër 9.



Alcarazi sfidon Sinnerin: Dua të jem sërish numri 1 në botë

MADRID, 14 GUSHT - Carlos Alcaraz nis sfidën për Jannik Sinner. Spanjolli, pas një vere plot suksese, nuk ka ndër mend të ndalet dhe synon të bëhet “numri 1” në botë. “Po luftoj për të qenë numri 1. Është diçka që dua ta arrij sa më

shpejt”, ka deklaruar fituesi i Roland Garros dhe Wimbledon këtë sezon. Distanca midis Sinner dhe Alcaraz është 450 pikë: 6410 për Jannik dhe 5960 për Carlos dhe parakalimi mund të ndodhë që në turneun Masters të Sinsinati. Alcaraz

mund ta kapërcejë Sinner nëse do të arrinte ta fitonte titullin në Sinsinnati, por italianin nuk duhet të shkojë përtej gjysmëfinales. “Ta përfundoj vitin si numri 1 është një nga synimet e mia kryesore tani. Mezi pres ta bëj dhe le të

shohim”, ka thënë spanjolli, aktualisht numri 3 i botës. Tani për tani, megjithatë, ai pozicionin e përket Sinner dhe mbrojtja mund të jetë e lehtë, të paktën deri në US Open, pasi ka më pak pikë për të mbrojtur se Alcaraz dhe Djokoviq.



Vullnetarja e Olimpiadës gjendet e vdekur pas ceremonisë së mbylljes

PARIS, 14 GUSHT - Lojërat Olimpikë janë një arsye për festë, gëzim dhe unitet. Por, ndonjëherë ndodhin gjëra të papritura dhe të trishta. Dhe pikërisht një episod i tillë ndodhi në Paris: një grua e akredituar si vullnetare në Stade de France, e cila u zhduk pasi mori pjesë në ceremoninë e mbylljes, u gjet e vdekur këtë të martë në shtëpinë e shoqëruesit të saj. Ai u arrestua nga policia, siç raporton agjencia franceze e lajmeve ATP, duke cituar disa burime policore. Rrethanat e vdekjes, aktualisht, duhet të vërtetohen nga hetuesit. Nga hetimet u konstatua se viktimja ishte parë për herë të fundit rreth orës një të mëngjesit, të hënën, në bulevardin Ney. Katër orë më vonë, familja e gruas së zhdukur njoftoi hetuesit se kishte marrë një mesazh nga një i njohur, ku thuhej se shoqëruesi i kësaj të



fundit kishte bërë “një marrëzi”. Policia shkoi në shtëpinë e shoqëruesit të gruas në lagjen 18, rreth orës 01:45, dhe aty zbuloi trupin e pjetë të viktimës, me një mavijosje në mollëz dhe “gjak në qafë”. Burri, i cili ndodhej pranë viktimës, u ndalua menjëherë. Rrjetet sociale janë mbushur me

mesazhe inkurajimi dhe mbështetjeje për miqtë dhe familjarët e viktimës. “Një hetim për akuzën e vrasjes me dashje i është besuar rrethit të dytë të policisë gjyqësore të Parisit (PDJ) pas zbulimit të trupit të pjetë të një të reje, 21 vjeçe, në një apartament në lagjen 18”, thuhet në njoftimin e policisë.

McLareni mesazh Red Bullit: Sfida do të jetë deri në fund për botërorin e konstruktorëve

SURREY, 14 GUSHT - Dallimi në rezultate, i shprehur nga Max Verstappen dhe Sergio Perez në Red Bull, do të thotë se dy renditjet e kampionatit botëror, ajo për pilotë dhe konstruktorë, u japin këndvështrime shumë të ndryshme pushimeve verore. Nëse në kampionatin e pilotëve rikthimi i Lando Norris kundër Verstappenit duket i ndërlikuar, por jo i pamundur (78 pikë diferencë), në klasifikimin e konstruktorëve skenarët janë shumë të ndryshëm: Red Bulli ka vetëm 42 pikë avantazh karshi McLarenit. Një diferencë që mund të korrigjohet edhe në një garë. Skuadra e McLarenit ka dy pilotë që shkojnë në pikë së fundi, ndërsa Red Bulli paguan për paraqitjen herë pas here të papranueshme të Perezit. Dhe duke marrë parasysh konfirmimin surprizë të meksikanit, McLarenit e



sheh kampionatin e konstruktorëve si një mundësi të shkëlqyer për t’iu rikthyer fitimit të një titulli. Sipas shefit të McLarenit, Zak Brown, lufta me Red Bullin do të vazhdojë deri në Abu Dhabi: “Do të jetë e vështirë. Besoj se titulli do të vijë në garën e fundit. Nuk ka shumë diferenca mes dy

makinave”. “Do të jetë një çështje për të parë se si sillet Perez: nëse ai arrin t’i sigurojë paraqitjet që është në gjendje të japë, do të jetë një luftë e vështirë. Nëse ai vazhdon të sillet siç ka bërë këtë vit, do të kemi një shans të mirë, sepse kemi dy pilotë që janë vazhdimisht përpara”, ka deklaruar Browni.

SHKURT

Empoli e dëshiron Kumbullën

Marash Kumbulla ka përfunduar në radarin e Empolit. Klubi toskan është në kërkim të një mbrojtësi për sezonin e ardhshëm, që po “troket” dhe emri i mbrojtësit shqiptar është më i lakuari orët e fundit. Për ta përforcuar këtë gjë, ka qenë vetë gazetari italian i specializuar në çështjet e merkatos, Gianluca Di Marzio, që ka publikuar lajmin lidhur me transferimin e mundshëm të mbrojtësit kuqezi. Kumublla pritet të largohet nga kryeqyteti, pasi Daniele De Rossi nuk e shikon si pjesë të projektit të tij për sezonin e ardhshëm. Në orët në vijim pritet të mbërrijë në Romë edhe oferta e parë për Kumbullën, i cili ishte i huazuar në gjysmën e dytë të sezonit të shkuar te Sassuolo.

Lazio e lë të lirë Hysajn

Elseid Hysaj nuk bën më pjesë në planet e Lazios, por për momentin nuk ka asnjë ofertë konkrete për të. Mediet italiane shkruajnë se mbrojtësi shqiptar është lënë i lirë nga drejtuesit e klubit që të largohet gjatë kësaj vere, pavarësisht se futbollisti ka një kontratë të vlefshme deri në 2025. Ata e kanë lënë të lirë, për një arsye të thjeshtë, se kërkojnë ta kursejnë pagën e tij sezonale pasi kujtojmë që Hysaj përfiton te Lazio 2.8 milionë euro në sezon. Agjenti i tij, Mario Guiffredi, zhvilloi një takim të martën me drejtuesit e klubit kryeqytetas, me këta të fundit që ia bënë të qartë edhe një herë vendimin e tyre. Pas mbledhjes, Guiffredi tha vetëm disa fjalë: “Për momentin nuk ka asgjë të re”. Nëse Hysaj qëndron në kryeqytet do ta ketë të vështirë të gjejë hapësira pasi Lazio afroi gjatë verës Nuno Taveres.

PSG-ja, afër transferimit të sulmuesit 19-vjeçar Desire Doue

Paris Saint-Germain duket se ka hequr dorë nga Osimhen dhe është pranë një tjetër objekti. Desire Doue është emri kryesor për momentin në kryeqytetin francez, teksa palët janë shumë afër marrëveshjes. 19-vjeçari është pjesë e Rennes, teksa në dy sezonet e para si profesionist ka zhvilluar 75 ndeshje duke shënuar 8 gola dhe duke dhuruar edhe 5 asistime. Kjo lëvizje në krahun tjetër mbyll përfundimisht mundësinë e kalimit te PSG-ja të Rayan Cherki me lojtarin që prej kohësh e ka shprehur hapur dëshirën për t’u transferuar në Paris.

Unitedi transferon dy mbrojtës nga Bayerni

Manchester Unitedi ka zyrtarizuar transferimin e dy futbollistëve, Matijs De Ligt dhe Nusair Mazraui nga Bayern Muncheni. Dy lojtarët ishin kërkuar me ngulm nga trajneri Erik Ten Hag, i cili i ka drejtuar ata në vitet kur ishte në bankinën e Ajaxit. De Ligt ka firmosur një kontratë pesëvjeçare që do ta shohë atë të jetë pjesë e klubit deri në vitin 2029, me mundësinë për ta zgjatur akordin edhe një tjetër vit. Ndërsa kontrata e Mazrauit zgjat deri në vitin 2028, gjithashtu me mundësinë e rinovimit të saj për një tjetër edicion. De Ligt u transferua për 45 milionë euro në klubin anglez, me bonuse deri në 5 milionë euro të tjera që do të vijnë në bazë të arritjeve individuale dhe të Unitedit në vitet në vijim. Ndërsa për Mazrauin u paguan 15 milionë euro plus një bonus i parashikuar prej 5 milionë eurosh.

Shpërblimi i pabesueshëm për kampionin olimpiq Carlos Yulo

Gjimnasti filipinas, 24-vjeçari Carlos Yulo, i cili fitoi dy medalje të arta në Lojërat Olimpikë në Paris, u mirëprit në vendin e tij si një hero me shpërblime të shumta me vlerë më shumë se një milion dollarë. Delegacioni olimpiq i Filipineve në Manila u mirëprit nga shumë tifozë,

si dhe presidenti i vendit, Ferdinand Marcos Junior, i cili u dha të gjithë olimpiqtëve nga një milion pesos (17 500 dollarë). Yulo ishte i vetmi që mori 20 milionë pesos (350 000 dollarë) për dy medalje ari dhe 100 000 dollarë të tjera nga Dhoma e Përfaqësuesve. Dhurata për

gjimnastin e madh kanë dorëzuar edhe biznesmenët e shumtë dhe kompani filipinase. Kështu ai mori një apartament me tri dhoma në qytetin e Taguig, dy transportues kryesorë në vend i premtnan bileta ajrore falas për gjithë jetën, teksa ai mori produkte të ndryshme

kozmetike, ushqime falas, ëmbëlsira, ekzaminime mjekësore dhe shumë gjëra të tjera. Platforma lokale e transmetimit i dha atij qasje të përjetshme në të gjithë përmbytjet e saj dhe çmime bujare u shpallën gjithashtu nga vendlindja e tij, Manila. Yulo fitoi

medaljen e artë në Paris në parket dhe më pas në ‘kalush’, dhe medaljet e tij konsiderohen si suksesi më i madh në historinë e Filipineve, një vend që fitoi medaljen e vetme të artë në Lojërat Olimpikë deri më tani në peshëngritje në “Tokio 2020”.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT



SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kojshia” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811302926 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTEN.JE


Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Kojshia” D.O.O. Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811302926 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Kojshia” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811302926 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valmir Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl VI - IX shfmu " Brigada 125 " Medvec.
- Shkelqim Memaj shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën , certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.
- Agush Kastrati shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X. QK "11 Marsi" Prizren.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjenet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjenet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

